

**CV DHE PAGAT E NËPUNËSVE QË SIPAS LIGJIT JANË SUBJEKT DEKLARIMI,  
PËRSHKRIM TË PROCEDURËS SË ZGJEDHJES, KOMPETENCAT DHE DETYRAT  
E TYRE**

Rektor i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, **PROF. DR. BEKTASH MEMA**

**CV e Rektorit të UGJ**

*Arsimi dhe titujt akademik*

Është diplomuar në degën Histori-Gjeografi, Fakulteti Fakulteti Histori-Filologji, Universiteti i Tiranës, në vitin 1981. Në vitin 1996 ka mbrojtur gradën shkencore “Doktor” në fushën e historisë me tezë disertacioni “*Lëvizja kombëtare dhe demokratike në qarkun e Gjirokastrës 1920-1924*”. Në vitin 2001 ka marrë titullin “Profesor i Asociuar” dhe në vitin 2009 titullin “Profesor”.

*Kariera profesionale*

Që prej vitit 1985 është personel akademik me kohë të plotë në departamentin e Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë, të fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë. Njëkohësisht ka shërbyer në funksione të ndryshme të këtij universiteti, si: Përgjegjës i Departamenti të Historisë (1993-2000), Kryetar i Degës Mësimore të Universitetit (2001-2003), Zëvendës Rektor (2004-2007), Kryetar i Këshillit të Administrimit të Universitetit (2008-2010), Kryetar i Qendrës së Ekzelencës për Mësimdhënjen (2010-2012), Zv/Dekan, Fakulteti Edukimit dhe Shkencave Shoqërore (2012-2014), Dekan, Fakulteti Edukimit dhe Shkencave Shoqërore (2014-2016), Rektor (2016-vazhdim).

*Publikime*

Gjatë karrierës së tij akademike ka punuar monografi dhe artikuj shkencorë të botuara brenda dhe jashtë vendit, ka marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, ka shkruar disa tekste universitare.

Veprimtaria kryesore shkencore, referuese dhe botuese, është fokusuar kryesisht në tematika kushtuar Rajonit Jugor të Shqipërisë, si:

- Assets values and specifics of cultural heritage in southern Albanian region (Ancient Chaonia);
- Prefektuara e Gjirokastrës (monografi);
- Veçoritë e zhvillimeve politike në Shqipërinë Jugore në fillim të viteve ‘20;
- Reforma bektashiane në filli të viteve ‘20;

- Burimet e autorëve antik për shtrirjen e Kaonisë;
- Vështrim rreth Epirit historik në periudhën byzantine;
- Archaeological site of Hadrianopolis (bashkëautor);
- Lugina e Drinos Gjirokastrër drejt një parku arkeologjik;
- Karakteristika të publiçistikës gjirokastrite në fillim të viteve '20;
- Pazari i Gjirokastrës në vitet 1920-1924;
- Aspects of political development in the Southern Albania 1920-1924;
- Projektet bilaterale arkeologjike dhe dinamikat e zhvillimit të tyre;
- Koinoni Antigonas dhe bashkësia kaone;
- Çështja e administrimit shtetëror të Prefekturës së Gjirokastrës (1912-1920);
- Zhvillimet demokratike në prefekturën e Gjirokastrës 1920-1924;
- Shkolla dhe Klube në Vilajetin e Janinës/Teqeja e Koshtanit (monografi);

Veprimtaria botuese akademike është fokusuar në botimin e teksteve dhe cikleve të leksioneve universitare, si:

- Njohuri për kërkimin shkencor në fushën e historisë;
- Histori e Popullit Shqiptar 1832-1912;
- Histori e Popullit Shqiptar 1912-1939;
- Bazat e Arkeologjisë.

*Paga sipas funksionit :*

Rektor i kategorisë “Profesor” , 179.400 ALL

Administrator i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, **Z. SEMI GOLEMI**

## **CV e Administratorit të UGJ**

### *Shkollimi*

2004-2008 Gjirokastër , Shkolla e Mesme “Siri Shaplo”

2008-2011 Tiranë , Fakulteti i Drejtësisë Universiteti Europian i Tiranës (Bachelor)

2011-2013 Tiranë, Master Shkencor Universiteti Europian i Tiranës

2016-2018 Dhoma Kombëtare e Avokatisë

2021-vashdim Master Profesional Administrim Publik

### *Eksperiencia Pune Relevante*

1. Shkurt 2009 - Korrik 2012 Zyrë Avokatie ( Asistent)
2. Korrik 2012 - Gusht 2015 Bashkia Gjirokastër, Përgjegjës i Zyrës Juridike ( Anëtare i njësisë se prokurimeve publike: Bashkia Gjirokastër, Qendra Ekonomike Arsimore, KF Luftëtari)
3. Janar 2014 - Qershor 2014 Sekretar i Këshillit Bashkiak ( Bashkia Gjirokastër)
4. Mars 2013 - Dhjetor 2013 Komisioni Zgjedhor i Administrimit Zonal ( Kzaz 78 Qarku Gjirokastër), Sekretar Kzaz
5. Shtator 2013 Konfederata e Sindikatës se Administratës Publike, Kryetar Qarku Gjirokastër.
6. Mars 2015 - Korrik 2015 Komisioni Zgjedhor i Administrimit Zonal ( KZAZ 80 Qarku Gjirokaster) Anëtar
7. Gusht 2015 - Qershor 2018 Sekretar i Këshillit Bashkiak ( Bashkia Gjirokastër
8. Mars 2017- Qershor 2017 Komisioni Zgjedhor i Administrimit Zonal ( KZAZ 78 Qarku Gjirokastër) Sekretar i KZAZ 78
9. Tetor 2018 - Shtator 2019 Aluizni Gjirokastër (ASHK) Jurist
10. Mars 2019 -Korrik 2019 Trajnues pranë KQZ
11. Tetor 2019 - vazhdim Administrator Universiteti “Eqrem Çabej Gjirokastër

### *Gjuhët e huaja*

- Anglisht
- Italisht

### *Paga sipas funksionit :*

Administrator , kategoria II/b

### **Procedura e zgjedhjes së Rektorit të UGJ**

- Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare, sipas përcaktimeve të ligjit pr arsimin e lart dhe krkimin shkencor.
- Në institucionet publike të arsimit të lartë, ai zgjidhet nga anëtarët e asamblevetë personelit akademik të njësive kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në përzgjedhjen e rektorit llogariten në masën dhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave. Kandidatët për rektor vetëkandidohen.
- Rektori në institucionet e arsimit të lartë mban titullin “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose dhe jashtë tij. Kriteret specifike përzgjedhëse të kandidatëve konkurrues përcak-tohen në statutin e UGJ.
- Mandati i rektorit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
- Presidenti i Republikës dekreton rektorët e institucioneve të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015.

### **Funksionet e Rektorit të UGJ**

- drejton dhe kontrollon veprimtarinë e UGJ-së për çështjet akademike dhe protokollare;
- drejton hartimin e planit strategjik të zhvillimit të UGJ-së dhe ndjek zbatimin e tij;
- përfaqëson UGJ-në në marrëdhënie me të tretët për çështjet akademike dhe protokollare;
- garanton zbatimin e akteve ligjore e nënligjore dhe interpreton në mënyrë përfundimtare statutin, rregulloren apo akte të tjera vetërregulluese që miratohen nga UGJ-ja;
- paraqet propozimet për aktet që janë në kompetencë për t’u shqyrtuar nga SA, BA, dhe KE;
- nënshkruan në emër të UGJ-së marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata vendase apo të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e UGJ-së, duke përfshirë dhe marrëveshje bashkëpunimi me karakter financiar, pas miratimit nga Bordi i Administrimit;
- cakton delegacionet dhe miraton planet e kualifikimit dhe të specializimit jashtë shtetit të stafit akademik dhe ndihmësakademik;
- miraton kriteret e punësimit të personelit akademik (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme), të personelit ndihmësakademik me karakter mësimor sipas propozimeve të njësisë

bazë, të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ sipas propozimeve të njësisë kryesore, të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ në nivel institucioni;

- krijon komision “*ad hoc*” për konkursin e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë, sipas përcaktimeve në këtë statut, si dhe trajton ankesat lidhur me zhvillimin e konkursit, sipas afateve të përcaktuara në këtë statut dhe, në rast konstatimi të parregullsive, vendos për ripërsëritjen e konkursit;
- miraton klasifikimin përfundimtar të konkursit të punësimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme, të personelit ndihmësakademik dhe emëron kandidatin/kandidatët e shpallur fitues;
- emëron dhe nënshkruan kontratat e punës me personelin akademik dhe ndihmësakademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme të UGJ-së;
- miraton dhënien e vitit akademik sabbatik sipas përcaktimeve në këtë statut;
- ushtron të drejtën e dhënies së masave disiplinore ndaj personelit akademik dhe ndihmësakademik;
- emëron drejtuesin e njësisë kryesore të shpallur fitues në zgjedhje, si dhe drejtuesin e njësisë kryesore në rastet e krijimit të një njësie të re kryesore;
- miraton propozimet e njësive bazë për punësimin e personelit akademik të ftuar;
- ka të drejtën e delegimit të firmës së vet personave në varësi;
- cakton një nga zv/rektorët për të ushtruar përkohësisht detyrën e rektorit;
- ka të drejtë të shfuqëzojë aktet e drejtuesëve të njësive kryesore për problematika procedurale dhe të mosrespektimit korrekt të akteve ligjore e nënligjore, si dhe të akteve të UGJ-së;
- bën propozime për strukturën dhe organikën e detajuar për të gjitha njësitë e universitetit dhe ia paraqet për miratim SA-së;
- nënshkruan diplomat e programeve profesionale, të ciklit të parë, të dytë, gradat, titujt certifikatat, pa të drejtë për të deleguar nënshkrimin;
- ushtron kontrole në fakultete për cilësinë e mësimdhënies, kërkimin shkencor, si dhe çdo çështje tjetër që kanë në kompetencë këto të fundit, si dhe ngre komisione të përkohshme këshillimore, të cilave u ngarkon detyra të posaçme apo struktura ndihmëse për zhvillimin e universitetit duke angazhuar stafin akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe studentë;
- jep leje pa të drejtë rroge sipas ligjit, si dhe leje për hyrjen e forcave të rendit në mjediset e universitetit apo mund të thërrasë këto forca në rast nevojë;

- Rektori, në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhra, udhëzime dhe akte të tjera sipas legjislacionit në fuqi.

### **Procedura e zgjedhjes së Administratorit të UGJ**

1. Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015.
2. Në institucionet publike të arsimit të lartë, ai përzgjidhet me konkurs të hapur, sipas kriterëve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit. Lista e kandidaturave që plotësojnë kriteret miratohet nga Senati Akademik. Emërimi i administratorit bëhet nga Bordi i Administrimit.
3. Administratori i institucionit publik të arsimit të lartë shkarkohet nga Bordi i Administrimit me 2/3 e votave të anëtarëve të tij.
4. Administratori duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin “Master i shkencave” në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune së paku shtatë vjet në këto fusha.
4. Administratori nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.
5. Administratori i raporton për veprimtarinë e tij Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik, sipas përcaktimeve të statutit të institucionit të arsimit të lartë.

### **Funksionet e Administratorit të UGJ**

- harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njëjësive kryesore dhe të njëjësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij;
- propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare e materiale, të cilat ia paraqet për miratim BA-së dhe mbikëqyr shpërndarjen e zbatimin e tyre;
- ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të UGJ-së në strukturat e varësisë së tij;
- zbaton të gjitha vendimet e BA-së dhe të SA-së, me karakter financiar dhe administrativ;
- i paraqet BA-së dhe SA-së raportin mbi veprimtarinë financiare të UGJ-së, në përfundim të vitit kalendarik;
- bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e UGJ-së për çështje të administrimit të përditshëm;
- i propozon BA-së kriteret specifike të punësimit të personelit administrativ;

- krijon komision “*ad hoc*” për konkursin e rekrutimit të personelit administrativ, sipas përcaktimeve në këtë statut;
- trajton ankesat lidhur me zhvillimin e konkursit për rekrutimin e personelit administrativ, sipas afateve të përcaktuara në statut;
- vendos ripërsëritjen e konkursit për rekrutimin e personelit administrativ në rast konstatimi të parregullsive;
- miraton klasifikimin përfundimtar të konkursit të rekrutimit të personelit administrativ dhe emëron kandidatin e shpallur fitues;
- harton dhe nënshkruan kontratën e punës me personelin administrativ të UGJ-së;
- emëron dhe shkarkon administratorët e njësisë kryesore dhe njësisë bazë pas miratimit të BA-së;
- plotëson kërkesat e rektorit për përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
- Nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ;
- Administratori i ushtron kompetencat e tij duke u shprehur me urdhra, udhëzime dhe akte të tjera siaps legjislacionit në fuqi.
- 

### **Procedurat e UGJ për marrjen e vendimeve**

Procedurat e marrjes së vendimeve nga autoritetet apo organet drejtuese të UGJ, në varësi të llojit dhe natyrës së tyre, mbështetet në ligjinë nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, statutin dhe rregulloren e UGJ-së, si dhe akte të tjera të brendshme.

Procedura më e zakonshme për marrjen e vendimeve apo miratimin e akteve të tjeranga organet drejtuese është mirëkuptimi dhe votimi i hapur. Në raste të veçanta votimi bëhet i fshehtë. E drejta e votës ushtrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nuk është e delegueshme. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, veç rasteve që parashikohen ndryshe në akte normative. Në rastin e votimeve nominale, të klasifikimit të punonjësve dhe për çështje të tjera (kur kjo kërkohet nga kryetari ose nga  $\frac{1}{2}$  (një e dyta) e të gjithë anëtarëve), vendimet merren me shumicë absolute (50% + 1 e të gjithë anëtarëve). Në rastet kur 50% e të gjithë anëtarëve rezulton numër me shifër 5 (pesë) pas presjes dhjetore, rrumbullakimi orientohet drejt numrit më të madh.